

Projekti i Kadastrit të Pronës së Paluajtshme dhe Infrastrukturës Gjeohapësinore të Kosovës (REGIP)

Termet e Referencës për

Specialist i Kadastrit për Kadastrin e Përçojave (2 pozita)

(Numri Ref i kontratës REGIP- XK-KCA-101500-CS-INDV)

Qeveria e Kosovës (QK) ka marrë një Kredi nga Shoqata Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA) në vlerë prej 14.60 milion EUR për të financuar Projektin e Kadastrit të Pronës së Paluajtshme & Infrastrukturës Gjeohapësinore, që pritet të zbatohet brenda një periudhe pesëvjeçare. Projekti i propozuar synon të ndihmojë Qeverinë e Kosovës që të rrisë transparencën dhe cilësinë e administrimit të tokës dhe të dhënave dhe shërbimeve gjeohapësinore. Agjencia Kadastrale e Kosovës (AKK) është agjencia zbatuese për projektin REGIP, brenda së cilës do të krijohet Njësia për Implementimin e Projektit (NjIP). NjIP do të ketë Koordinatorin e NjIP-it, Specialistin e Prokurimit, Specialistin e Menaxhimit Financiar, Specialistin për Marrëdhënie me Publikun dhe Komunikim dhe staf tjetër teknik si Specialistë për GIS/Kadastër, etj.

NjIP do të jetë përgjegjëse për zbatimin e përditshëm të projektit dhe për ofrimin e mbikëqyrjes teknike specifike të aktiviteteve të projektit. NjIP do të jetë gjithashtu përgjegjëse për të gjitha aspektet e besueshmërisë, siç janë prokurimi, menaxhimi financiar, monitorimi dhe vlerësimi, dhe masat mbrojtëse sipas Projektit.

Komponentët e projektit janë Komponenti A - Politika, Mbështetja Ligjore dhe Institucionale; Komponenti B - Modernizimi i Kadastrit; Komponenti C - TIK dhe Infrastruktura Gjeohapësinore dhe Komponenti D - Menaxhimi i Projektit, Ngritja e Kapaciteteve, Informimi i Publikut dhe Monitorimi dhe Vlerësimi.

NjIP është në kërkim të dy (2) Specialistëve të Kadastrit me orar të plotë për të ndihmuar NjIP/AKK-në në çështjet e Kadastrit të Përçojave në kuadër të projektit REGIP.

Objektivat

Objektivi i këtij aktiviteti është që mbështesë AKK-në në identifikimin e të dhënave ekzistuese për përçojat në komuna dhe institucione të tjera si dhe për të ofruar mbështetje në monitorimin e punës në emër të AKK-së gjatë zbatimit të aktiviteteve të Kadastrit të Përçojave për pilot projektin në Prishtinë dhe grumbullimin e të dhënave në 3-5 qytete të tjera më të mëdha në Kosovë. AKK synon të angazhojë dy Specialistë të Kadastrit për të mbështetur zhvillimin, ekzekutimin dhe mbikëqyrjen e Kadastrit të Përçojave në emër të AKK-së.

Përgjegjësitë e Specialistit të Kadastrit

Specialisti i Kadastrit është pozitë me orar të plotë për një periudhë të caktuar kohore prej dy viteve që do të jetë e vendosur brenda hapësirave të AKK-së në Prishtinë, me udhëtime të shpeshta në terren dhe në zyrat kadastrale komunale në mbështetje të operacioneve kadastrale. Specialistët do të punojnë së bashku dhe do të jenë përgjegjës për detyrat në Kadastrin e Përçojave

Detyrat kryesore të Specialistëve të Kadastrit do të përfshijnë, por nuk kufizohen në:

- Identifikon të dhënat ekzistuese të përçojave në institucionet tjera dhe për t'i ofruar mbështetje AKK-së në monitorimin e punës gjatë zbatimit të aktiviteteve të Kadastrit të Përçojave për pilot projektin në Prishtinë dhe mbledhjen e të dhënave në 3-5 qytete të tjera më të mëdha në Kosovë. **Identifikimi përfshin:**
 - identifikimin fillestar të të dhënave ekzistuese të përçojave në institucionet përkatëse si pronarë të përçojave,
 - specifikimin e detajuar të të dhënave të përçojave, sipas institucionit/burimit për çdo grup të dhënash të identifikuar, do të kërkohet të përcaktohet:
 - Formati i të dhënave - digjitale ose në letër
 - Nëse të dhënat mbahen në baza të rregullta
 - Shkalla e hartave të përçojave
 - Nëse të dhënat janë në formë digjitale, cili është modeli i të dhënave dhe në çfarë lloj softueri ruhen të dhënat
 - Në rastin e të dhënave digjitale, a e mbajnë historinë e tyre, etj.
- Mbështet AKK-në për hartimin e udhëzimeve teknike për Kadastrin e Përçojave si pjesë e grupeve punuese të AKK-së;
- Harton Udhëzimeve Administrative për njësitë e Kadastrit të Përçojave;
- Merr pjesë në përgatitjen e TeR-ve, merr pjesë në komisionet vlerësuese për aktivitetet që kanë të bëjnë me kadastrin dhe aktivitetet tjera në AKK;
- Finalizon specifikimet teknike të njërive të përçojave për zhvillimin e mëtutjeshëm të SIKTK (Grafik, Tekstual dhe Gjeoportali);
- Ofron mbështetje në zbatimin dhe mbikëqyrjen e Projekteve të Kadastrit të Përçojave në 3-5 qytete të tjera më të mëdha në Kosovë;
- Çdo detyrë tjetër e kërkuar nga Drejtori Ekzekutiv i AKK-së, Drejtori i Drejtorisë së Kadastrit të AKK-së dhe Koordinatorin i NjIP-it lidhur me projektin REGIP.

Specialist i Kadastrit

Kualifikimet dhe përvoja e nevojshme

- Diplomë universitare në gjeodezi, gjeomatikë, kadastër, administrim të tokës ose fusha të ngjashme;
- Minimumi 3 vite përvojë pune në kadastër, administrim të tokës ose menaxhim të përçojave;
- Njohuritë gjuhësore: Njohuri/thelbësore të njohjes së gjuhës angleze dhe shqipe; njohja e gjuhës serbe do të ishte përparësi;
- Kërkoheftësi të shkëlqyera në Microsoft Word, Excel dhe Power Point;
- Njohuri të dëshmuara dhe përvojë praktike në punën me sistemet e GIS-it ose dbms, ose njohuri dhe përvojë ekzistuese të punës me sistemet e menaxhimit të objekteve të përçojave
- Njohuritë, shkathtësitë dhe përvoja me organizatat ndërkombëtare si Banka Botërore ose Partnerët e tjerë Ndërkombëtarë për Zhvillim do të jenë përparësi e shtuar;

Kompetencat dhe aftësitë e kërkuara

- Të jetë i organizuar mirë dhe i aftë për të mësuar shpejt sistemet dhe procedurat komplekse;
- Aftësi për të punuar në mënyrë të pavarur dhe efektive në mjedis ekipor
- Aftësi për të punuar në mënyrë efektive me mbikëqyrje minimale dhe vëmendje të kujdesshme ndaj detajeve;
- Aftësi për të marrë iniciativë, për të caktuar prioritetet dhe për të koordinuar punën, për të përballuar presionin në arritjen e afateve strikte dhe orar të gjatë.;
- Aftësi për të punuar në një mjedis pune të shumëllojshëm multietnik dhe multikulturor;

Periudha e performancës

Specialistët e Kadastrit do të punojë me orar të plotë dhe kohëzgjatja e kontratës do të jetë për dy vite nga data e emërimit të tyre. Kohëzgjatja e kontratës do t'i nënshtrohet performancës së kënaqshme të rënë dakord gjatë vlerësimit vjetor zyrtar të planifikuar. Paga do të kryhet në bazë të tarifës mujore të rënë dakord në kontratë. Specialist i Kadastrit pritet të fillojë shërbimet me nënshkrimin e kontratës.

Emërimi pritet të fillojë në qershor 2023.

Raportimi

Specialistët e Kadastrit do t'i raportojnë Drejtorit të Drejtorisë për Kadastër dhe të Drejtat mbi Pronat e Paluajtshme dhe do të dorëzojnë raportin mujor të vijshmërisë në punë për të llogaritur ditët aktuale të punës gjatë muajit kalendarik.

Procesi i përzgjedhjes

Individët me përvojë dhe të kualifikuar do të përzgjidhen sipas dispozitave të Rregulloreve të Prokurimit të Bankës Botërore për Huamarrësit e Financimit të Projekteve Investuese (FPI), të nxjerra në korrik të vitit 2016 dhe të rishikuara në nëntor të viti 2017 dhe gusht të vitit 2018, bazuar në thirrjen e hapur.

Agjencia Kadastrale e Kosovës është e përkushtuar ndaj parimeve të mundësive të barabarta të punësimit dhe po ashtu është e përkushtuar që të marrë vendime për punësim në bazë të meritave. Jemi të përkushtuar të zbatojmë ligjet e shtetit që ofrojnë mundësi të barabarta punësimi, si dhe të gjitha ligjet që kanë të bëjnë me kushtet e punësimit. Agjencia dëshiron të mbajë një mjedis pune pa ngacmime seksuale dhe pa diskriminim në bazë të racës, fesë, ngjyrës, origjinës kombëtare, orientimit seksual, aftësive të kufizuara fizike dhe mendore, statusit martesor, moshës ose ndonjë kushti tjetër të mbrojtur nga ligjet e shtetit.